

## Vendim nr. 216 datë 02.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini	Anëtare

në datën 02.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 29 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **ARDJAN REÇI**, përfaqësuar nga avokat Edmond Bunaj, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1957, datë 14.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pika 1, 11, pika 3, 15, 17, pika 1, 18, pikat 1 dhe 2, 35, pika 3, 41, pika 1, 42, 43, 116, 142, 146, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ardjan Reçi (*kërkuesi*), me urdhrin nr. 98, datë 01.08.2011 të kryetarit të Bashkisë Mamurras është emëruar specialist arsimit në zyrën e arsimit në Bashkinë Mamurras

dhe me shkresën nr. 2564, datë 31.12.2014, është konfirmuar si nëpunës civil. Në referim të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ka ndryshuar ndarja administrativoterritoriale e njësive të qeverisjes vendore dhe është krijuar Bashkia Kurbin, duke iu nënshtruar ristrukturimit, proces i cili ka sjellë si pasojë shkurtrimin e numrit të punonjësve. Me vendimin nr. 8, datë 11.08.2015 të këshillit bashkiak Kurbin është miratuar numri i punonjësve të bashkisë dhe me urdhrin nr. 12, datë 12.08.2015 të kryetarit të Bashkisë Kurbin është miratuar struktura organizative saj. Ndërsa me urdhrin nr. 13, datë 12.08.2015 të kryetarit të Bashkisë Kurbin është ngritur komisioni për zbatimin e procedurave të transferimit të nëpunësve civilë me rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të ish-bashkive dhe komunave të Bashkisë Kurbin.

2. Me shkresën nr. 1301/2, datë 16.08.2015, komisioni për zbatimin e procedurave të transferimit të nëpunësve civilë ka dhënë propozimet lidhur me sistemimin e nëpunësve civilë dhe me shkresën nr. 1396, datë 17.08.2015, kryetari i Bashkisë Kurbin, mbi bazën e këtyre propozimeve, ka njoftuar kërkuesin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të shkrirjes së pozicionit dhe mospërshtatjes në strukturën e bashkisë. Me vendimin nr. 1396/1, datë 24.08.2015, është vendosur lirimi i tij nga Shërbimi Civil, kalimi në listëpritje dhe ndërprerja e marrëdhënies financiare në datën 30.09.2015.

3. Kërkuesi, në datën 15.09.2015, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit për njoftim për zgjidhje kontrate pune. Shfuqizimin e aktit administrativ për lirimin nga Shërbimi Civil. Rregullimin e pasojave juridike të vendimeve administrative, duke e kthyer paditësin në vendin e mëparshëm të punës dhe detyrimin e të paditurit të paguajë pagën e specialistit të arsimit në njësinë administrative Mamurras deri në momentin e kthimit në detyrë, lejen vjetore të vitit 2015 dhe shpërblimin për vjetërsinë në punë nga viti 2011 deri në përfundimin e saj.”*.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5291, datë 22.10.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se kërkuesi është larguar në nga Shërbimi Civil për shkak të ristrukturimit të palës së paditur. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3882/4067, datë 21.09.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5291, datë 22.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë. Ndërprerja marrëdhënies së punës ka ardhur për shkak të ristrukturimit të institucionit, i cili përbën një nga rastet e lirimit të nëpunësit civil nga Shërbimi Civil, referuar

nenit 66, pika a/1, të ligjit nr. 152, datë 07.10.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*). Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1957, datë 14.05.2024, bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

7. Në datën 08.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

8.1.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka arsytuar se shkaqet e rekursit nuk përmbajnë kritere nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, duke mos marrë në shqyrtim asnjë nga pretendimet e tij. Po kështu, gjykatat e zakonshme nuk janë shprehur për të gjitha pretendimet dhe shkaqet e ankimit të kërkuesit dhe kanë mbajtur qëndrim në favor të palës së paditur, duke u shprehur se shkëputja e marrëdhënieve të punës është bërë për shkak të ristrukturimit. Seanca dëgjimore është bërë pa prezencën e përfaqësuesit të Departamenti i Administratës Publike (*DAP*).

8.1.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, për shkak të shkeljes së standardeve të numërtimit, evidentimit dhe sistemimit të akteve në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe për shkak të mungesës së procedurave të shortimit mes trupave gjykues nr.1 dhe nr. 2 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të përcaktuara në vendimin nr. 47/2021 të Këshillit të Gjykatës së Lartë.

8.1.3. *Së drejtës për t’u dëgjuar*, pasi relacioni i gjyqtarit për shqyrtimin paraprak nuk përmban datë ose të dhëna nëse u është shpërndarë edhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, ndërkohë që gjykimi i çështjes është kryer në hapësirë kohore 10 minuta. Referimi i Kolegjit Administrativ në vendimmarrje të tjera të tij, pa i cituar konkretisht ato, i ka cenuar të drejtën për të debatuar. Po kështu, kolegji nuk ka kryer shpalljen për gjykimin në dhomë këshillimi për

vendimin e revokimit siç parashikojnë dispozitat procedurale, duke i mohuar kërkuessit të drejtën për të paraqitur pretendime për këtë seancë ekstraprocedurale.

- 8.1.4. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi Kolegji Administrativ nuk ka marrë parasysh asnjë nga pretendimet e parashtruara në rekurs, duke lejuar në këtë mënyrë të prevalojnë argumentet e palës kundërrekursuese. Po kështu, kundërrekursi nuk rezulton i dokumentuar në listën e akteve të administruara në dosje ose t'i jetë dorëzuar relatorit dhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues.
- 8.1.5. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit* në drejtim të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi në krahasim me çështjet e tjera të gjykuara në të njëjtën ditë, çështja e kërkuessit është gjykuar tej afatit të arsyeshëm.
- 8.1.6. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuessit, pasi në objektin e padisë kërkimet i janë referuar Kodit të Punës, ndërkohë kërkuessi ka cituar edhe ligjin për nëpunësin civil dhe kërkimet në lidhje me të në kërkesëpadi. Vendimit për mospranimin e rekursit i mungon tërësisht analiza juridikoligjore, duke mos i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuessit. Kolegji Administrativ është shprehur se gjykata e apelit në vendimin e saj i ka ezauruar dhe shteruar të gjitha pretendimet e kërkuessit, çka do të thotë se kolegji nuk ka marrë në shqyrtim faktin se vendi i tij nuk është suprimuar, por ai është larguar nga puna për shkaqe politike dhe në bashkinë e re vendi i punës në pozicionin e kërkuessit është ekzistues.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuessit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin

e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve, duke paraqitur dy shkaqe: (i) Kolegji Administrativ nuk ka marrë parasysh asnjë nga pretendimet e parashtruara në rekurs, duke lejuar në këtë mënyrë të prevalojnë argumentet e palës kundërrekursuese; (ii) kundërrekursi nuk rezultoi i dokumentuar në listën e akteve të administruara në dosje ose t’i jetë dorëzuar relatorit dhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues.

12. Për sa i takon shkakut (ii), Kolegji vëren se ai lidhet me të drejtat e personave të tjerë, ndaj kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka provuar të drejtën e cenuar dhe interesin e tij të ligjshëm vetjak për mbrojtjen e tij. Ndërsa, për sa u takon pretendimeve të tjera, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

13. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shkrimin e mjeteve juridike efektive*. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit* me argumentin se gjykata nuk ka respektuar standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi në krahasim me çështjet e tjera të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë në të njëjtën ditë, çështja e tij është shqyrtuar tej afatit të arsyeshëm. Kolegji vëren se lidhur me të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës pa shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive në dispozicion të tij, sipas neneve 399/1 – 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për më tepër, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit për shkak të diskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, por pa parashtruar ndonjë shkak diskriminimi dhe as argument konkret, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 14.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 08.07.2024. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

16. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

17. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me *cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga gjykatë e paanshme dhe së drejtës për t’u dëgjuar*, kërkuesi ka parashtruar shprehimisht si shkak shkeljen e standardeve të numërtimit, evidentimit dhe sistemimit të akteve në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe mungesën e procedurave të shortimit mes trupave gjyqësore nr.1 dhe nr. 2 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të përcaktuara në vendimin nr. 47/2021 të Këshillit të Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se ai është haptazi i pabazuar, sepse jo vetëm që ka të bëjë me aspekte të organizimit të brendshëm të punës në Gjykatën e Lartë pa provuar se si ato kanë ndikuar në të drejtat themelore të kërkuesit (siç janë argumentet për krijimin e dosjes gjyqësore), por nuk janë shoqëruar nga

asnjë provë për t'i bazuar ato (siç është argumenti për mosrespektimin e procedurave të shortit). Për rrjedhojë, Kolegji çmon se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Gjithashtu, në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve për sa i përket shkakut (i) (se Kolegji Administrativ nuk ka marrë parasysh asnjë nga pretendimet e parashtruara në rekurs, duke lejuar në këtë mënyrë të prevalojnë argumentet e palës kundërrekursuese) dhe standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore. Duke qenë se në thelb këto pretendime lidhen me mënyrën se si gjykatat kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre, Kolegji vlerëson se ato *prima facie* bëjnë pjesë në kompetencën e Gjykatës dhe do të trajtohen në këndvështrim të cenimit të standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

19. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Po kështu, gjykatat e zakonshme nuk janë shprehur për të gjitha pretendimet dhe shkaqet e ankimit të kërkuarit dhe kanë mbajtur qëndrim në favor të palës së paditur. Gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, pasi në objektin e padisë kërkimet i janë referuar Kodit të Punës, ndërkohe që kërkuesi ka cituar edhe ligjin për nëpunësin civil dhe kërkimet në lidhje me të në kërkesëpadi. Seanca dëgjimore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është bërë pa prezencën e përfaqësuesit të DAP-it. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se shkaqet e rekursit nuk përmbajnë kritere nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, duke mos marrë në shqyrtim asnjë nga shkaqet e tij. Vendimit për mospranimin e rekursit i mungon tërësisht analiza juridikologjore, duke mos i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuarit. Kolegji Administrativ është shprehur se gjykata e apelit në vendimin e saj i ka ezauruar dhe shteruar të gjitha pretendimet e kërkuarit, çka do të thotë se kolegji nuk ka marrë në shqyrtim faktin se vendi i tij nuk është suprimuar, por ai është larguar nga puna për shkaqe politike dhe në bashkinë e re vendi i punës në pozicionin e kërkuarit është ekzistues.

20. E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura

ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Kolegji vëren se për shkak të ndryshimit të ndarjes administrativoterritoriale, pozicioni i punës së kërkuesit i është nënshtruar ristrukturimit me pasojë shkurtimin e vendit të punës. Për këtë shkak, kërkuesi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila pasi ka gjykuar çështjen mbështetur në ligjin nr. 152/2013 ka vendosur rrëzimin e saj me arsyetimin se kërkuesi është larguar nga Shërbimi Civil për shkak të ristrukturimit të institucionit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka dalë në përfundimin se bazuar në ligjin nr. 152/2013 ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur për shkak të ristrukturimit të institucionit. Edhe sipas kësaj gjykate, ndryshimi i ndarjes administrativoterritoriale i njësive të qeverisjes vendore ka sjellë ndryshime strukturore edhe në institucionin e kërkuesit, i cili është shoqëruar me ulje të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë. Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se në interpretim dhe zbatim të nenit 66, pika 4, shkronja "b", të ligjit nr. 152/2013 kësaj dispozite rezulton se lirimi nga Shërbimi Civil deklarohet me vendim të DAP-it, vetëm për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues. Për sa kohë që paditësi nuk përfshihej në këtë kategori nëpunësish civilë, lirimi i tij nga Shërbimi Civil nuk duhej të deklarohet me vendim të DAP-it.

23. Në lidhje me pretendimin për vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ajo gjykatë ka arsyetuar se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Po kështu, Kolegji vëren se gjykata në arsyetimin e saj ka theksuar se është detyrë e rekursuesit të parashtojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Nëse shkaqet ligjore nuk arrihen të parashtrihen dhe të argumentohen sipas kërkesave të ligjit, atëherë Gjykata e Lartë është e detyruar të vendosë mospranimin e rekursit. Po kështu, ajo ka arritur në konkluzionin se përfundimet në të cilat ka arritur Gjykata Administrative e Apelit nuk janë kundërshtuar në rekursin e paraqitur nga pala paditëse sipas atyre kërkesave që



parashikohen në ligj. Për rrjedhojë, përderisa rekursuesi nuk arrin të japë asnjë argument mbi shkeljen e ligjit material e procedural ose shkeljet e rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, Gjykata Administrative e Apelit nuk rezulton të ketë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, të mos ketë garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ose të mos ketë sqaruar rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

24. Ndërsa për sa i përket pretendimit të kërkuarit se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim faktin se ai është hequr nga puna për bindje politike, Kolegji vë në dukje se detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse. Nëse gjykata ka dalë në konkluzionin se përfundimet e gjykatës së apelit në rekurs nuk janë kundërshtuar sipas parashikimeve ligjore dhe kërkuari nuk ka dhënë asnjë argument për shkeljet e ligjit material dhe procedural, ose shkeljet e rënda procedurale, kjo do të thotë se nga ajo gjykatë janë marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet, për rrjedhojë ka vendosur mospranimin e rekursit.

25. Në vlerësim të vendimmarrjeve të mësipërme, Kolegji, bazuar në rrethanat e mësipërme, vlerëson se gjykatat kanë marrë në analizë të gjitha argumentet e parashtruara prej kërkuarit, duke dhënë përgjigje të arsyetuara për shkaqet në të cilat kanë mbështetur qëndrimin e tyre. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë në vlerësim të argumenteve të kërkuarit në tërësi ka vepruar brenda kompetencave dhe funksionit të kësaj gjykate, si gjykatë ligji, dhe nuk rezulton që vendimi të jetë i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë ose arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuarit, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsytimit.

26. Në këto kushte, për sa kohë që vendimet e kundërshtuara përmbushin kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e vendimit, vlerësohet se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore janë haptazi të pabazuara.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VENDOSI:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.